



Prishtinë: 24 qershor 2008
Kodi i ZRRE-së: D_095_2008
Nr.i Referencës ERO/CPD_D_77_04_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e dhëna Zyrës së Rregullatorit për Energji në Nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe proceset e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK në ZRRE: ZRRE/DMK_V_77_04_08
5. Parashtrimin e kundërshtimit të vendimit të DMK-së nga ana e konsumatorit, drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 18 prill 2008;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2008 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i konsumatorit z. Agron Haziri (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 90040407) kundër Vendimit të DMK për arsye të paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së me datë 26 nëntor 2007 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizionit të Furnizimit – Departamentit për Konsumatorë me numër reference DPR – CO1 – 04 lidhur me transferin e borxhit të vjetër.
2. KEK Sh.A me datë 24 tetor 2007 me anë të një Urdhër Lejimi / Ngarkimi nr. 14473 në shifrën e re të konsumatorit DPR – 90040407 (IL) ka ngarkuar konsumatorin në shumë prej 1,167.60 €, në emër të bartjes së borxhit nga shifra e mëparshme e tij 29489.
Provë: Urdhër Lejimi / Ngarkimi nr. 14473 i datës 24 tetor 2007
3. Konsumatori me datë 15 nëntor 2007 i drejtohet KEK Sh.A – Divizionit të Furnizimit - Departamentit për Konsumatorëve për tu ankuar për bartjen e borxhit.
Provë: Dëftesa e ankesës së konsumatorit në KEK Sh.A
4. KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar lidhur me transferin e borxhit në arsyetimin se: *“transferi i borxhit është realizuar duke u bazuar në vendimin e lëshuar të ZRRE-së nr. 157 dt. 27 shtator 2007 dhe deklaratës së lexuesit dt. 22 tetor 2007”.*
Provë: Përgjigja e KEK Sh.A me numër reference DPR – CO1 - 04
5. Me datë 26 nëntor 2007 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e regjistruar e konsumatorit në DMK të ZRRE-së, Nr 137/11 2007



6. Me datë 10 prill 2008 DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK Sh.A dhe konsumatorit ka vendosur që të refuzojë ankesën e konsumatorit.
Provë: Përgjigja e DMK të ZRRE-së me datë 12 mars 2008
7. Me datë 18 prill 2008 konsumatori ka parashtruar kundërshtimin e tij kundër vendimit të DMK të ZRRE-së në Bordin e ZRRE-së.

Andaj për arsyet e paraqitura më lart, Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta refuzojë konsumatorin si në arsyetimin e paraqitur në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Bordi i ZRRE-së

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar